

D E K R E T
Nr.7449, datë 5.1.1991

**PËR PËRDORIMIN E ARMËVE TË ZJARRIT NGA FORCAT E RUAJTJES SË
KUFIRIT, TË RUAJTJES SË RENDIT PUBLIK DHE NGA ROJAT USHTARAKE E
CIVILE TË ARMATOSURA**

Neni 1

Forcat e ruajtjes së kufirit, të ruajtjes së rendit publik, rojat ushtarake dhe rojat civile të armatosura për të mbrojtur kufijtë shtetërorë, rendin shtetëror e shoqëror të vendosur me dispozitat Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, personin, të drejtat e interesat e tij të ligjshme nga një sulm i padrejtë, i vërtetë e i çastit, kanë të drejtë të përdorin edhe armët e zjarrit kundër personit ose personave që kryejnë sulmin.

Neni 2

Forcat e ruajtjes së kufirit shtetëror i përdorin armët që kanë në përdorim, kur:

- a) sulmohen kufijtë e Republikës së Shqipërisë nga forcat ushtarake të huaja;
- b) sulmohen kufijtë e Republikës së Shqipërisë, nga banda të armatosura, nga jashtë ose nga brenda;
- c) sulmohen ata vetë ose shtetas të veçantë nga banda ose individë të armatosur, nga jashtë ose nga brenda;
- ç) nuk mund të sigurojnë kryerjen e detyrës për ruajtjen e kufijve shtetërorë me mjete e mënyra të tjera nga shkelës të kufirit, nga brenda ose nga jashtë, si dhe në raste të tjera kur janë siguruar të dhëna për kryerjen e një krimi të rëndë kundër shtetit, jetës a shëndetit ose kundër pasurisë;
- e) kundër shtetasve që rrëmbejnë mjete kryesore ajrore, detare e të transportit hekurudhor.

Për rastet e parashikuara në shkronjën "a" të këtij neni zjarri hapet me urdhër të komandës eprore, kurse për rastet e tjera zjarri hapet sipas rrethanave konkrete për të paralizuar ose sprapsur sulmin.

Rregullat e caktuara në këtë dispozitë janë të vlefshme edhe për forcat e tjera ose individët e armatosur që vihen në ndihmë të forcave të ruajtjes së kufirit shtetëror.

Neni 3

Forcat e ruajtjes së rendit publik përdorin armët që kanë në përdorim, kur:

- a) është duke u kryer një krim i rëndë, terror, diversion, shkatërrim ose dëmtim i pasurisë shtetërore, shoqërore a private me zjarr, lëndë eksplozive, armë ose mjete të tjera të rrezikshme, vrasje, grabitje a vjedhje e bankave, e arkave të kursimit, objekte ku mbahen vlera të mëdha materiale e kulturore, e makinave që transportojnë vlera monetare ose materiale të rëndësishme, dhe përdhunim nga një grup personash a rrëmbim personash;
- b) është duke u kryer një krim me armë zjarri ose me armë të tjera, me lëndë plasëse, a helmuese, me mjete që, kur vihen në lëvizje, nuk mund të kontrollohen;
- c) personi që ka kryer, është duke kryer, ose që ka të dhëna të mjaftueshme se ka kryer një krim të rëndë, përpiqet t'i shpëtojë ndalimit ose arrestimit;
- ç) personat e dënuar, të arrestuar, ose të ndaluar tentojnë të largohen nga vendet e kryerjes së dënimit, dhomat e paraburgimit ose vendet ku mbahen për t'u shoqëruar, nga personat që i shoqërojnë ose nga mjetet me të cilët transportohen;

d) persona të ndryshëm tentojnë të lirojnë me dhunë ose armë të dënuarit a të paraburgosurit nga vendet e kryerjes së dënimit, dhomat e paraburgimit, vendet ku mbahen për t'u shoqëruar ose mjetet me të cilat transportohen;

dh) persona të ndryshëm përpiqen të kalojnë me dhunë apo duke përdorur armë ose mjete në vendet që ruhen me postbllok nga organet e ruajtjes së rendit publik;

e) forcat e ruajtjes së rendit ose të tretë sulmohen me armë a mjete të tjera të rrezikshme për jetën dhe në rrethanat konkrete, sulmi nuk mund të sprapset me mjete ose mënyra të tjera.

Neni 4

Armët e zjarrit përdoren nga rojat ushtarake a civile të armatosura kundër personave që përpiqen të futen me forcë ose me mjete në zona të ndaluara ushtarake a në objekte të rëndësishme të veçantë, të caktuara me akte nënligjore.

Neni 5

Armët e zjarrit nuk lejohen të përdoren:

a) kundër personave që në dukje tregojnë se janë të mitur (fëmijë);

b) në vende publike, ku ka mbledhje e grumbullime njerëzish dhe vihet në rrezik jeta e të tjerëve.

Armët e zjarrit në këto raste mund të përdoren kundër personave të veçantë, ose grup personash që kryejnë vepra të dukshme dhune kundër personit ose pasurisë, që në vetvete përbëjnë shkelje të rënda të ligjit, vetëm kur përdorimi i masave të tjera shtrënguese nuk ka dhënë rezultatet e dëshiruara.

Neni 6

Arma e zjarrit përdoret si mjet ekstrem për të frenuar ose paralizuar veprimet e kundërligjshme të personit ose të personave, të përcaktuara në dispozitat e mësipërme, kur mjetet e tjera nuk kanë dhënë rezultat, ose kur duket qartë që përdorimi i tyre nuk do të ketë sukses.

Me ndërprerjen, pushimin, përfundimin e sulmit ose dorëzimin e sulmuesit, duhet të ndërpritet edhe përdorimi i armëve të zjarrit.

Neni 7

Para përdorimit të armëve të zjarrit, personat, ndaj të cilëve ato do të përdoren, duhet të paralajmërohen me zë të lartë e të qartë.

Në rast se veprimtaria e kundërligjshme nuk ndërpritet edhe pas paralajmërimit, ky përsëritet me anë të një qitjeje me armë në ajër dhe vetëm pas kësaj mund të qëllohet në drejtim të personit ose të personave që sulmojnë.

Kur rrethanat nuk lejojnë në asnjë mënyrë zbatimin e rregullave të mësipërme, armët e zjarrit përdoren pa paralajmërim.

Neni 8

Forcat e ruajtjes së kufirit shtetëror, të ruajtjes së rendit publik dhe rojat ushtarake a civile të armatosura, kur përdorin armët e zjarrit në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në këtë dekret, përgjigjen sipas Kodit Penal.

Neni 9

Personat që përdorin armët kundër forcave të ruajtjes së kufirit shtetëror a të ruajtjes së rendit publik, kundër rojave ushtarake a civile të armatosura, kur ata janë duke ushtruar detyrën e tyre sipas ligjit, për veprën penale që kryejnë, përgjigjen në bazë të Kodit Penal dhe dënohen për krimin e kryer në rrethana rënduese.

Neni 10

Ngarkohen Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Mbrojtjes Popullore të nxjerrin rregulloret përkatëse për zbatimin e këtij dekreti.

Neni 11

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.